

V E N D I M

“Vendosje sekuestro preventive”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR - SOKOL TONA

Asistuar prej sekretares gjyqësore **Dasantila Bejko**, sot më dt.**23 Prill 2012**, me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane, përfaqësuar nga prokurori **Z.Gentian Osmani**, si mori në shqyrtim kerkesen penale me nr.755 akti qe i perket:

KERKUES Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tirane.

OBJEKTI: Vendosjen e sekuestros preventive ne kuader te hetimeve te proçedimit penal nr.1060 te viti 2012.

Baza ligjore: Nga Neni 274 i Kodit Proçedures Penale.

Gjykata ne perfundim te shqyrtimit gjyqësor pasi administroi provat ftoi prokurorin ne bisedimet perfundimtare ku prokurori kerkoj pranimin e kerkeses sipas objektit.

V E R E N

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane i eshte drejtuar me kerkese kesaj gjykate, siç percaktohet ne pjesen hyrese te ketij vendimi.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kesaj kerkese, rezulton se ajo nuk eshte rezultat i nje argumentimi ligjor dhe e mbeshtetur ne Ligj dhe per pasoje duhet te rrezohet.

Keshtu, organi i prokurorisë faktin objekt te ketij shqyrtimi gjyqësor ia parashtroi ne menyren si vijon:

Në datë 01.03.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 1060 për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale” të parashikuar nga Neni 287 i Kodit Penal.

Proçedimi eshte regjistruar bazuar ne materialet e referuara dhe verifikimet e kryera nga Seksioni Kunder Pastrimit te Parave ne Drejtorise e Policise se Qarkut Tirane. Per shtetasin SH.K ka dyshime te bazuara ne lidhje me shumat e investuara ne biznese dhe pasuri te paluajtshme dhe origjinen e ketyre shumave. Pasurite jane te regjistruara kryesisht ne emer te te atit, shtetasit R.K. Nderkohe qe burim i ketyre pasurive dyshohet te jene te ardhura me origjine nga aktivitete kriminale te shtetasit SH.K.

Nga veprimet e kryera ka rezultuar:

Zyra Qendrore Interpol – Tirana na ka informuar ne lidhje me aktivitetet kriminale te shtetasit SH.K:

1.Ky shtetas ka hyrë ilegalisht në Gjermani dhe është daktiloskopuar dhe fotografuar për fallsifikim dokumentash. Më datën 04.06.2007 është lëshuar një ndalim hyrje në Gjermani nga autoritetet e Mynihut.

2.Ky shtetas është raportuar nga autoritetet policore të Askoli Piceno Itali, si anëtar i një organizate kriminale e cila merret me trafikun e kokainës dhe heroinës ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë. Guardia di Financa e ka hetuar gjatë periudhës Maj 2007 deri në Qershor të 2009 në kuadër të operacionit të koduar “CEASAR”.

Nga informacioni i marre nga burime te hapura, ne dt. 29.02.2012 shtetasi SH.K, i njohur dhe me emrin (...) eshte arrestuar ne Rome - Itali si kreu i nje organizate kriminale me baze ne Rome dhe qe trafikonte kokainen nga Hollanda dhe Belgjika ne drejtim te Italise dhe Greqise. Se bashku me keta shtetas jane arrestuar dhe 12 anetare te tjere te organizates kriminale, midis tyre shtetasit shqiptare E.B, A.D dhe GJ.S. Ne cilesine e proves materiale jane sekuestruar rreth 20 kilograme kokaine, 3 pistoleta te vjedhura dhe municione te tjera. Hetimet per kete grup kriminal kishin filluar ne vitin 2007 nga ana e Sektorit te Antimafias Guarda Di Financa ne Firenze Itali.

3.Ky shtetas eshte daktiloskopuar ne Zvicër ne date 27.01.2011 per kryerje te vepres penale te “Trafikimit te lendeve narkotike”.

4.Zyra Nderlidhese e Interpolit ne Kosove ka informuar se shtetasi SH.K ka nje precedent penal ne vitin 2003 per vepren penale te “Fallsifikimit te dokumentave”.

Jane zhvilluar veprime hetimore lidhur me aktivitetet tregtare dhe me pasurite e paluajtshme dhe te luajtshme qe shtetasi SH.K apo te aferm te tij kane ne pronesi ne Shqiperi. Duke permbledhur te dhenat e administruara deri ne keto momente rezulton se:

Qendra Kombetare e Regjistrimit ka kthyer pergjigje se ne emer te shtetasit R.K (i ati i SH.K) figuron i regjistruar nje biznes me emrin “Kadana” sh.p.k i regjistruar ne date 04.03.2010 me aktivitet ne fushen e tregtisë, import - eksportit te mallrave, restorant - Hoteleri, lavazh, tregti karburanti me pakice, me status aktiv i cili e ushtron aktivitetin ne nje godine 3 - kateshe ne Bërxull – Tiranë ku eshte dhe selia e shoqerise.

Nga Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Tirane jemi informuar se ne emer te shtetasit R.K rezultojne te regjistruara keto pasuri:

-Nje pasuri me Nr.(.....) ne Z.K 2066 Kamëz-Tirane, lloji i pasurise Arë me siperfaqe 1050 meter katror, blere me daten 18.10.2006 me nje çmim 150.000 leke nga shtetasi E.Ç.

-Nje pasuri me Nr. (.....) ne Z.K 1167 Bërxull-Tirane, lloji i pasurise Arë me siperfaqe 6.000 meter katror, blere me daten 06.09.2005 me nje çmim 5.400.000 leke nga shtetasi F.A.

Gjithashtu nga verifikimet e kryera rezulton qe mbi kete siperfaqe toke eshte ngritur nje godine tre – kateshe e cila eshte vendosur si seli e shoqerise “Kadana” sh.p.k.

Nga sa siper sipas organit te akuzes, ekziston dyshimi i arsyeshem qe nga shtetasi SH.K dhe R.K te jete kryer vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale, ne bashkepunim” parashikuar nga Neni 287/2 i Kodit Penal.

Aktiviteti kriminal i shtetasi SH.K provohet nga te dhenat e sjella nga Interpol – Tirana.

Parate e siguruar nga ky aktivitet jane investuar ne pasuri te paluajtshme te vendosura ne emer te babait te tij, shtetasi R.K.

Per sa siper, sipas organit te akuzes, ekziston dyshimi i arsyeshem qe nga shtetasi SH.K te jete kryer vepra penale e “Pastrimit të produkteve të veprës penale” parashikuar nga Neni 287 i Kodit Penal, pasi kemi te bejme me produkte te vepres penale qe rrjedhin ose fitohen drejtperdrejt ose terthorazi nga kryerja e vepres penale, e cila eshte “Trafikimi i lendeve narkotike” parashikuar nga Kodi Penal Shqiptar ne Nenin 283/a.

Kjo veper penale eshte kryer jashte shtetit shqiptar, ne Itali.

Ne funksion te krekeses si me siper, organi i akuzes i paraqiti kesaj gjykate edhe dokumentacionin e administruar nga institucionet perkatese rreth pasurive dhe objekteve te sipercituara.

Ne konkluzionin sipas te cilit kerkesa objekt gjykim duhet te rrezohet, gjykata arrin duke konsideruar sa vijon:

Keshtu ne rastin ne gjykim dhe me provat e administruara sillet bindja se shtetasi SH.K, eshte shtetas shqiptar dhe me precedent penal, ku tashme ai eshte i arrestuar ne Itali per trafikim te lendeve narkotike.

Po keshtu sillet bindja edhe ne faktin se shtetasi R.K, eshte i ati i tij, ne emer te te cilit figurojne pasurite e sipercitua.

Por sic u sipertregua, organi i akuzes ndonese ne menyre te shprehur ne kerkesen objekt gjykim citon se: “..Parate e siguruar nga ky aktivitet jane investuar ne pasuri te paluajtshme te vendosura ne emer te babait te tij, shtetasi R.K” -ai organ- nuk i paraqiti kesaj gjykate asnje prove, e cila te sherbeje si nje dyshim i arsyeshem dhe i mjaftueshem, qe realisht pasurite ne emer te shtetasi R.K e kane burimin nga aktiviteti kriminal i djalit te tij. Vetem faktin se shtetasi R.K eshte prindi i shtetasi SH.K gjykata e konsideron te pamjaftueshem, per te vendosur sekuestron mbi te gjitha pasurite ne emer te tij.

Do te krijonte dyshimin e arsyeshem per gjykatën dhe per pasoje edhe nevojën e vendosjes se sekuestron preventive mbi pasurite e mesiperme, paraqitja e akteve te tilla te cilat te dokumentonin, pikerisht lidhjet e paleve te mesiperme ne veprime te tilla si transferta financiare, transakcione te ndryshme, akte ligjore shitjesh, dhurimi, apo blerjesh, midis shtetasi SH.K dhe familjareve te tij. Ne kushtet e mungeses se akteve te tilla, gjykata nuk e konsideron nje veprim juridik te motivuar, vendosjen e sekuestron preventive mbi pasurite e shtetasi R.K, vetem per faktin se ai eshte i ati i shtetasi SH.K, ne nje kohe qe nga aktet e administruara, shtetasi R.K rezulton te kete edhe femije te tjere.

PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar te Nenit 274 te Kodit Proçedures Penale:

V E N D O S I

-Rrezimin e kërkesës me nr.755 akti dt.23.04.2012 si te pabazuar ne prova.

-Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit.

U shpall sot në Tiranë më datë 23 Prill 2012.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R

Dasantila BEJKO

SOKOL TONA